



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punihjeni/Prudato Received/Deliverty	20.04.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMESHKK	2267/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.277/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.277/2022 të datës 23.03.2022 të parashtruar nga ankuesja nga Mitrovica, kundër organit të punësimit/Komunës së Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.277/2022 e datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në bazë të Akt Emërimit të datës 29.12.2015 në pozitën Zyrtar për Qarkullim Rrugor në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 13.01.2022 ka parashtruar kërkesë për harmonizim të koeficientit tek Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, të cilën kërkesë udhëheqësi i drejtpërdrejtë konkretisht Udhëheqësi i Sektorit të Shërbimeve Publike më datë 20.01.2022 e ka përcjell tek Zyra e Personelit e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke kërkuar që ankueses t'i mundësohet harmonizimi i koeficientit nga gjashtë (6) në shtatë (7).

Menaxheri i Personelit i Komunës së Mitrovicës së Jugut, më datë 07.02.2022, përmes përgjigjes ka njoftuar Udhëheqësin e Sektorit për Shërbime Publike se pozita që mbar në bazë të katalogut të vendeve të punës është sipas gradës 10 dhe koeficienti i kësaj pozite është gjashtë (6), ndërsa nëse do të ishte grada 9 me të drejtë do të kërkonte harmonizimin e koeficientit sipas gradës.

Në bazë të fletëdorëzimit Udhëheqësi i Sektorit për Shërbime Publike, përgjigjen e Menaxherit të Personelit e ka pranuar më datë 09.02.2022.

Ankuesja përmes postës më datë 21.03.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 23.03.2022 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe është regjistruar me numër të ankesës A.nr.277/2022 me Nr.Prot:1551/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.03.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Këshilli, me datë 14.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:1551/2022 të datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë e datës 07.02.2022 nga Menaxheri i Personalit; Kërkesën për harmonizim të koeficientit nga ankuesja e datës 13.01.2022; Rekomandimin e datës 17.09.2018; Akt Emërimit e datës 29.12.2015 dhe 07.12.2012 në emër të ankueses; Përshkrimin e detyrave të punës Zyrtar për Qarkullim Rrugor i datës 18.12.2015; Përshkrimi i punësi sipas Sistemit Informativ dhe Menaxhues të Burimeve Njerëzore; Kërkesën e datës 31.07.2017 nga Drejtori i Shërbimeve Publike për Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financave; Kërkesën e datës 28.02.2017 nga ankuesja për Kryetarin e Komunës; Emailin e datës 19.09.2017 nga Zyrtari Kryesor Financiar; Organogramin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë; Përshkrimin e detyrave të Punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Trafik; Njoftim për ankuesen e datës 12.07.2017; Kërkesën e datës 03.03.2016 nga ankuesja për Drejtorin për Buxhet dhe Financa; Përgjigje në kërkesë e datës 17.12.2015 nga ankuesja për Shefin e Personelit; Kërkesën e datës 30.11.2015 nga Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit; Zarin e datës 21.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.03.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 14.04.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 14.12.2015 nga Drejtori i Drejtorisë së Inspektionit për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë; Vendimin me Nr. 01/112-98670/3 i datës 18.12.2015 për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil; Listën e pagave mars 2022; Shkresën me arsyetim për harmonizim të koeficientit nga Shefi i Sektorit për Shërbime Publike për Zyrën e Personelit e datës 20.01.2022; Fletëdorëzimi i datës 09.02.2022; Komunikimet me email të datës 19.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Meqenëse në bazë të provave të lëndës, përgjigja në kërkesë e datë 07.02.2022 e Menaxherit të Personelit i është përcjell Udhëheqësit të Sektorit për Shërbime Publike, atëherë më datë

19.04.2022 kemi kërkuar deklaratë nga ankuesja dhe Udhëheqësi i Sektorit për Shërbime Publike se kur përgjigja e datës 07.02.2022 i është dorëzuar ankueses, ndërsa të dy më datë 19.04.2022 përmes emailit kanë deklaruar që më datë 09.02.2022 është pranuar përgjigja e datës 07.02.2022.

Lidhur me këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se meqenëse përgjigja në ankesë e datës 07.02.2022 e Menaxherit të Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut nuk ka udhëzim juridik, në kuptim të nenit 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj”*, ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e afatshme dhe e pranueshme në kuptim të afatshmërisë, sipas nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që koeficienti për pozitën Zyrtar për Qarkullim Rrugor duhet të jetë shtatë (7) e jo gjashtë (6), andaj kërkoj të bëhet harmonizimin i koeficientit nga gjashtë (6) në shtatë (7).

Bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, si dhe duke u bazuar në pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar ankuesja fillimisht ka mbajtur pozitën Inspektor i Komunikacionit sipas Akt Emërimit të datës 07.12.2012 dhe për këtë pozitë është paguar me koeficient gjashtë (6), ndërsa pas transferimit të përhershëm sipas Vendimit me Nr. 01/112-98670/3 të datës 18.12.2015 të Kryetarit të Komunës në pozitën Zyrtar për Qarkullim Rrugor, për të cilin ka dhënë pëlqim dhe ankuesja, më datë 29.12.2015 i është bërë plotësim ndryshimi i akt emërimit prapë me koeficient gjashtë (6).

Ndërsa në bazë të provave të lëndës, Komuna e Mitrovicës së Jugut, në vitin 2017 ka bërë përpjekje për harmonizim të koeficientit për rastin e ankueses, por një gjë e tillë nuk është realizuar, ndërsa pas vitit 2017 nuk ka ndonjë përpjekje të tillë.

Duke pasur parasysh faktin e ngritjes, respektivisht harmonizimit të koeficientëve, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se neni 7 paragrafi 1 dhe 1 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili përcakton: *“Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat”*, rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ligjërisht ngritja apo harmonizimi i koeficientëve për nëpunësit civil, mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet dëshmohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria

përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa, kështu përderisa nuk ka planifikim buxhetit apo nuk ka kërkesë nga institucioni ku nëpunësi civil është duke e ushtruar pozitën tek institucionet gjegjëse, atëherë përderisa nuk plotësohen kushtet e tilla ligjore, nëpunësi civil paguhet me pagë siç është përcaktuar në aktin e emërimit me të cilin ka themeluar marrëdhënien e tij të punës, siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 9 paragrafin 1 përcakton se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës", si dhe nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave", kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.277/2022

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

